



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**MINISTRIA E ARSIMIT**  
**AGJENCIA KOMBËTARE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR**

**LISTË VERIFIKIMI PËR Udhëzimin nr.12, datë 27.04.2015, "Për mbledhjen, përpunimin dhe mbrojtjen e të dhënave personale të punonjësve arsimorë dhe nxënësve në institucionet arsimore të sistemit parauniversitar, përmbajtjen e dosjeve të tyre personale, si dhe për mbledhjen, përpunimin dhe mbrojtjen e të dhënave kontaktuese të prindërve/kujdestarëve ligjorë të nxënësve"**

Nr.

Datë:

Qarku:

Subjekt i inspektuar për herë të:

**1. TË DHËNA TË PËRGJITHSHME TË SUBJEKTIT**

1.	<b>Emri i Subjektit</b>	
2.	<b>Data e Fillimit të aktivitetit</b>	
3.	<b>Lloji i aktivitetit ekonomik</b>	
4.	<b>Adresa - Qendër (Rrugë, Njësi, Telefon)</b>	
5.	<b>Adresa të tjera - Filiale (Rrugë, Njësi, Telefon)</b>	
6.	<b>Përfaqësuesi i subjektit (emër, atësia, mbiemri)</b>	
7.	<b>NUIS - QKR (Nr Unik i Identifikimit)</b>	
8.	<b>Tipi i Pronësisë</b>	<b>Tipi i Subjektit</b>

LISTË VERIFIKIMI PËR Udhëzimin nr.12, datë 27.04.2015, "Për mbledhjen, përpunimin dhe mbrojtjen e të dhënave personale të punonjësve arsimorë dhe nxënësve në institucionet arsimore të sistemit parauniversitar, përmbajtjen e dosjeve të tyre personale, si dhe për mbledhjen, përpunimin dhe mbrojtjen e të dhënave kontaktuese të prindërve/kujdestarëve ligjorë të nxënësve"

Subjekti:

\_\_\_\_\_

Nr.NIPT:

\_\_\_\_\_

Adresa:

---

Administratori:

---

Drejtori i shkollës:

---

Tel/Cel:

---

Fax:

---

E-mail:

---

Lloji Aktivitetit:(Kopsht/AB/AML)

---

Në zbatim të ligjit/ve nr.

---

datë

---

Për

---

VKM/ve nr.

---

datë

---

Për

---

Nr .	Baza Ligjore	Pyetje	Vlerësimi (Po/Jo/Nuk Aplikohej)	Komente
---------	--------------	--------	---------------------------------------	---------

Nr	Baza Ligjore	Pyetje	Vlerësimi (Po/Jo/Nuk Aplikohet)	Komente
1	Neni 5, Kreu I Udhëzimi nr. 12, datë 27.04.2015,	A ka respektuar institucioni arsimor, gjatë përpunimit të të dhënave personale, parimin e përpunimit të ligjshëm të të dhënave personale dhe a ka respektuar dhe garantuar të drejtat dhe liritë themelore të njeriut dhe në veçanti, të drejtën e ruajtjes së jetës private të subjekteve?		
2	Gërma a, Neni 6, Kreu I Udhëzimi nr. 12, datë 27.04.2015,	A disponon institucioni arsimor të dhënat personale të punonjësve arsimorë, të tilla si: - emri, atësia, mbiemri; - numri ID; - gjinia; - datëlindja; - gjendja civile; - lloji i diplomës (diplomave) të studimeve universitare; - viti i diplomimit; - emërtimi i shkollës së lartë ku është diplomuar; - institucionet arsimore ku ka punuar që në fillim dhe deri në vitin mësimor dhe datat e fillimit të punës në to; - vendndodhja e këtyre institucioneve; - lënda/lëndët që ka dhënë deri në vitin arsimor aktual; - ngarkesa javore në vitin mësimor aktual; - kategoria aktuale e kualifikimit; - certifikata të trajnimeve; - numri total i krediteve; - pjesëmartja në organizmat e institucionit arsimor; - justifikimi me shkrim i mungesave; - vlerësimi me shkrim nga drejtori i shkollës; - çmimet në konkurse; - shpërblimet për merita profesionale; - masat disiplinore në fuqi; të dhëna personale të pranuar prej tij/saj nëpërmjet deklaratës së pëlqimit?		

Nr	Baza Ligjore	Pyetje	Vlerësimi (Po/Jo/Nuk Aplikohet)	Komente
3	Gërma b, Neni 6, Kreu I Udhëzimi nr. 12, datë 27.04.2015,	A disponon institucioni arsimor të dhënat personale të nxënësit, të tilla si: - të dhënat e paraqitura në pikat 2, 4 dhe 5 të kreut III, të këtij udhëzimi; - lloji i kopshtit (me drekë, pa drekë); - kartela e vaksinimeve; - numri ID; - forma e arsimimit dhe lloji i shkollës/ dega e saj; - lëndët me zgjedhje; - të dhëna të tjera të nxënësit në regjistrat dhe dëftesat e diplomat e tij; - certifikata; - fitues në konkurse e olimpiada; - justifikime të mungesave; - masat disiplinore në fuqi; - të dhëna personale të pranuar prej tij/saj nëpërmjet deklaratës së pëlqimit? Të dhënat e prindërve ose kujdestarëve ligjorë, si: - niveli arsimor; - gjendja civile; - punësimi; - a janë gjallë; - a janë emigrantë etj?		
4	Gërma b/1 Neni 6, Kreu I, e ndryshuar me germën e, Pika 2, udhëzimi nr. 28, datë 07.09.2018	A përmbajnë të dhënat kontaktuese të prindërve/ kujdestarëve ligjorë? - emër; - mbiemër; - bashkia; - shkolla; - numri i telefonit; - adresa e-mail?		
5	Gërma c, Neni 6, Kreu I Udhëzimi nr. 12, datë 27.04.2015,	A ka përfshirë institucioni arsimor, ndër të dhënat personale të subjekteve, të dhëna për ta dhe prindërit/fëmijët e tyre: - origjinën racore; - origjinën etnike; - mendimet politike; - anëtarësimin në sindikata; - besimin fetar; - bindjet filozofike; - dënimin penal; - të dhënat për shëndetin dhe jetën seksuale? Përrjashtuar rastet e kësaj pike (c), institucioni arsimor a ka përpunuar të dhënat sensitive të nxënësve, vetëm nëse subjekti ka dhënë pëlqimin, që mund të revokohet në çdo rast dhe e bën të paligjshëm përpunimin e mëtejshëm të të dhënave, si dhe në të gjitha rastet e parashikuara në nenin 7, pika 2, e ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar?		
6	Gërma a, Neni 7, Kreu I Udhëzimi nr. 12, datë 27.04.2015,	A ka siguruar drejtori i institucionit arsimor kushtet teknike dhe organizative për mbledhjen, përpunimin dhe mbrojtjen e të dhënave personale të subjekteve të institucionit përkatës, si dhe a ka plotësuar dhe përditësuar dosjet personale?		

Nr	Baza Ligjore	Pyetje	Vlerësimi (Po/Jo/Nuk Aplikohet)	Komente
7	Gërma b, Neni 7, Kreu I Udhëzimi nr. 12, datë 27.04.2015,	A është njohur drejtori i institucionit arsimor dhe a ka njohur kontrolluesit dhe përpunuesin me ligjin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale dhe aktet e tij nënligjore?		
8	Gërma a, Neni 8, Kreu I Udhëzimi nr. 12, datë 27.04.2015,	A ka informuar drejtori i institucionit arsimor punonjësit arsimorë, nxënësit e moshës mbi 18 vjeç, si dhe prindërit/kujdestarët ligjorë për arsyen e mbledhjes së të dhënave personale të subjekteve, përdorimin dhe mbrojtjen e tyre?		
9	Gërma b, Neni 8, Kreu I Udhëzimi nr. 12, datë 27.04.2015,	A janë njohur punonjësi arsimor, prindërit e nxënësit dhe nxënësi i moshës mbi 18 vjeç, pas kërkesës së tyre me shkrim, drejtuar drejtorit të institucionit, me të dhënat personale dhe dosjen personale të subjektit përkatës, në prani të kontrolluesit ose përpunuesit?		
10	Gërma a, Neni 9, Kreu I Udhëzimi nr. 12, datë 27.04.2015,	A kanë dhënë punonjësi arsimor, prindi i nxënësit dhe nxënësi mbi moshën 18 vjeç, pëlqimin për mbledhjen e një të dhëne të veçantë personale?		
11	Gërma b, Neni 9, Kreu I Udhëzimi nr. 12, datë 27.04.2015,	A është deklaruar pëlqimi me shkrim dhe a është bërë sipas modelit të shtojcave 2/1 dhe 2/2, bashkëlidhur këtij udhëzimi?		
12	Gërma c, Neni 9, Kreu I Udhëzimi nr. 12, datë 27.04.2015,	A ka mundur institucioni arsimor në çdo kohë të rrethojë deklarimet e pëlqimit? '		
13	Gërma d, Neni 9, Kreu I Udhëzimi nr. 12, datë 27.04.2015,	A ka dhënë pëlqim me shkrim, prindi i nxënësit ose nxënësi mbi moshën 18 vjeç, për afishimin e fotos së nxënësit/të tij në mjedisin e institucionit arsimor dhe publikimin e fotografisë ose videos në internet, pasi është njohur paraprakisht me pasojat e këtij publikimi?		
14	Gërma a, Neni 10, Kreu I Udhëzimi nr. 12, datë 27.04.2015,	Kur një e dhënë personale ka pasur ndonjë gabim, a është korrigjuar nga kontrolluesi /përpunuesi vetëm në prani të drejtorit të institucionit arsimor, si dhe a është nënshkruar nga drejtori dhe kontrolluesi /përpunuesi krahas vendit të korrigjuar, duke shënuar edhe datën e korrigjimit?		

Nr	Baza Ligjore	Pyetje	Vlerësimi (Po/Jo/Nuk Aplikohet)	Komente
15	Gërma b, Neni 10, Kreu I Udhëzimi nr. 12, datë 27.04.2015,	A e ka kontrolluar drejtori i institucionit arsimor plotësinë dhe saktësinë e dosjeve personale, të paktën një herë në fund të vitit shkollor, si dhe a ka paraqitur konstatimet e tij me një shkresë, me nënshkrimin e tij dhe datën e kontrollit?  A është kontrolluar plotësia dhe saktësia e dosjes personale të drejtorit të institucionit arsimor një herë në vit nga përpunuesi i tij?		
16	Gërma a, Neni 11, Kreu I Udhëzimi nr. 12, datë 27.04.2015,	A janë ruajtur dosjet personale në dosje ose skeda elektronike?		
17	Gërma b, Neni 11, Kreu I Udhëzimi nr. 12, datë 27.04.2015,	A janë ruajtur dosjet personale përgjithmonë në një mjedis të institucionit arsimor, në kushte sigurie, të mbrojtura nga dëmtimi?		
18	Gërma c, Neni 11, Kreu I Udhëzimi nr. 12, datë 27.04.2015,	A janë fshirë të dhënat e tjera personale të nxënësit, që nuk i përkasin dosjes personale, në kohën e përcaktuar sipas akteve nënligjore në fuqi, të miratuara nga ministri i ministrisë përgjegjëse për arsimin?		
19	Gërma d, Neni 11, Kreu I Udhëzimi nr. 12, datë 27.04.2015,	A ka ndaluar institucioni arsimor hyrjen e personave të paautorizuar me shkrim nga drejtuesi i institucionit arsimor, në mjedisin e punës së kontrolluesit/përpunuesit të të dhënave personale dhe në mjedisin ku ruhen dosjet personale të subjekteve?		
20	Gërma e, Neni 11, Kreu I Udhëzimi nr. 12, datë 27.04.2015,	A ka njoftuar kontrolluesi/ përpunuesi i të dhënave personale drejtorin e institucionit, në rastin e humbjes/zhdokjes së dokumentit me të dhënat personale, si dhe a ka marrë masa për të përcaktuar rrethanat në të cilat ka humbur apo është zhdukur dokumenti, si dhe për të eliminuar pasojat e dëmshme?		
21	Gërma a, Neni 13, Kreu I Udhëzimi nr. 12, datë 27.04.2015,	A i ka mbrojtur kontrolluesi /përpunuesi i skedave elektronike, ato me fjalëkalime të forta, që njihen vetëm prej tij dhe që i ka ndryshuar çdo 3 ose 6 muaj?		
22	Gërma b, Neni 13, Kreu I Udhëzimi nr. 12, datë 27.04.2015,	A i ka ruajtur kontrolluesi/ përpunuesi në kushte sigurie, të mbrojtura nga dëmtimi, kopje të file-ve të dosjeve të subjekteve ose të pjesëve të tyre që janë paraqitur në formë elektronike?		

Nr	Baza Ligjore	Pyetje	Vlerësimi (Po/Jo/Nuk Aplikohet)	Komente
23	Gërma c, Neni 13, Kreu I Udhëzimi nr. 12, datë 27.04.2015,	A ka bërë një specialist i IT (i shkollës ose i njësisë arsimore vendore) rregullimet e kompjuterit që mban dosjet personale të subjekteve ose një pjesë të tyre pas kërkesës me shkrim të drejtorit të institucionit?		
24	Gërma a, Neni 14, Kreu I Udhëzimi nr. 12, datë 27.04.2015,	A kanë ruajtur drejtori i institucionit arsimor, kontrolluesit e përpunuesit dhe personat e autorizuar për të dhënat personale, fshehtësinë e të dhënave personale?		
25	Gërma a, Neni 14, Kreu I Udhëzimi nr. 12, datë 27.04.2015,	A ruan kontrolluesi/përpunuesi fshehtësinë edhe pasi nuk ushtron më funksionin e tij?		
26	Gërma b, Neni 14, Kreu I Udhëzimi nr. 12, datë 27.04.2015,	A kanë nënshkruar deklaratën e fshehtësisë (konfidencialitetit), sipas modelit të shtojcës 3, bashkëlidhur këtij udhëzimi të gjithë personat që kanë të bëjnë me dosjet personale?		
27	Gërma c, Neni 14, Kreu I Udhëzimi nr. 12, datë 27.04.2015,	A u ka vënë drejtori i institucionit arsimor në dispozicion të tjerëve, jashtë institucionit, të dhënat personale të një subjekti të institucionit, me përjashtim të rasteve kur subjekti i të dhënave, prindi/kujdestari i ligjshëm, ka paraqitur kërkesën ose ka dhënë pëlqimin?		
28	Gërma e, Neni 14, Kreu I Udhëzimi nr. 12, datë 27.04.2015,	A u ka dhënë institucioni arsimor të dhëna personale të një subjekti personave të panjohur ose personave, identiteti i të cilëve nuk mund të identifikohet?		
29	Gërma f, Neni 14, Kreu I Udhëzimi nr. 12, datë 27.04.2015,	A u ka dhënë institucioni arsimor të dhëna personale të një subjekti nëpërmjet telefonit?		
30	Gërma g, Neni 14, Kreu I Udhëzimi nr. 12, datë 27.04.2015,	A i janë dhënë prindit që nuk është kujdestar ligjor të dhënat për nxënësin ose prindin e tij që është kujdestar ligjor?		
31	Gërma h, Neni 14, Kreu I Udhëzimi nr. 12, datë 27.04.2015,	Kur kujdestaria ligjore është e përbashkët, a janë njohur të dy kujdestarët ligjorë me të dhënat personale dhe dosjen personale të fëmijës (nxënësit) dhe me të dhënat e veta që mbahen nga institucioni arsimor, por nuk janë njohur me të dhënat e kujdestarit tjetër ligjor?		

Nr	Baza Ligjore	Pyetje	Vlerësimi (Po/Jo/Nuk Aplikohet)	Komente
32	Gërma i, Neni 14, Kreu I Udhëzimi nr. 12, datë 27.04.2015,	<p>Kur të dhënat e një subjekti janë përdorur për parandalimin ose ndjekjen e një vepre penale, a kanë verifikuar drejtori i institucionit arsimor dhe kontrolluesi/ përpunuesi autorizimin e personit që ka kërkuar njohjen me dosjen personale të një subjekti, a e kanë arkivuar autorizimin dhe a e kanë lejuar njohjen me dosjen në fjalë, kur kanë konfirmuar rregullsinë e autorizimit?</p> <p>A është realizuar procedura kur është kërkuar dosja personale e drejtuesit të institucionit, nga përpunuesi përkatës?</p>		
33	Gërma a, Neni 15, Kreu I Udhëzimi nr. 12, datë 27.04.2015,	A ka ruajtur psikologu/punonjësi social privatësinë e informacionit që ka siguruar gjatë punës në institucionet arsimore		
34	Gërma b, Neni 15, Kreu I Udhëzimi nr. 12, datë 27.04.2015,	A është bërë realizimi i testeve psikologjike dhe çdo komunikim tjetër i psikologut/punonjësit social drejtpërdrejt vetëm me nxënësin, me miratimin me shkrim të prindërve, me përjashtim të rastit kur komunikimi ka qenë pjesë e një hetimi për një abuzim dhe është kërkuar nga autoriteti përkatës?		
35	Gërma c, Neni 15, Kreu I Udhëzimi nr. 12, datë 27.04.2015,	<p>A ruhet në dosje të posaçme. informacioni për nxënësit dhe familjet e tyre, i marrë për shkak të detyrës nga psikologu/punonjësi social?</p> <p>A është siguruar dosja nga përdorimi i saj prej personave të paautorizuar?</p>		
36	Gërma a, Neni 16, Kreu I Udhëzimi nr. 12, datë 27.04.2015,	A u ka dërguar drejtori i institucionit arsimor, zyrtarisht njësisve arsimore vendore përkatëse, ministrisë përgjegjëse për arsimin dhe çdo institucioni qeveritar që përcaktohet me urdhër të ministrit të ministrisë përgjegjëse për arsimin, të dhëna të caktuara personale të subjekteve, pa i identifikuar këta?		
37	Gërma b, Neni 16, Kreu I Udhëzimi nr. 12, datë 27.04.2015,	A u janë vënë të dhënat personale të një subjekti të institucionit arsimor, në dispozicion organizatave të caktuara jofitimprurëse, vetëm pas miratimit me shkrim të drejtorit të institucionit arsimor dhe pa zbuluar identitetin e subjekteve?		

Nr	Baza Ligjore	Pyetje	Vlerësimi (Po/Jo/Nuk Aplikohet)	Komente
38	Gërma a, Neni 17, Kreu I Udhëzimi nr. 12, datë 27.04.2015,	A u është dhënë e drejta punonjësit arsimor, prindit të nxënësit dhe nxënësit mbi moshën 18 vjeç, të ankohen me shkrim dhe të kërkojnë takim me kontrolluesin ose përpunuesin përkatës për kushtet e sigurisë, të fshehtësisë, për plotësinë dhe saktësinë e të dhënave personale dhe të dosjes së subjektit dhe kanë marrë përgjigje me shkrim brenda 30 ditëve pune?		
39	Gërma b, Neni 17, Kreu I Udhëzimi nr. 12, datë 27.04.2015,	Punonjësi arsimor, prindi i nxënësit dhe nxënësi mbi moshën 18 vjeç, nëse nuk kanë qenë të kënaqur nga përgjigja e kërkesës së tyre, e përshkruar në pikën 17/a, a u është dhënë e drejta të ankohen me shkrim dhe të kërkojnë takim me drejtorin e institucionit, duke i paraqitur ankesën dhe përgjigjen me shkrim dhe kanë marrë përgjigje me shkrim brenda 10 ditëve pune?		
40	Gërma a, Neni 18, Kreu I Udhëzimi nr. 12, datë 27.04.2015,	A ka dorëzuar drejtori i institucionit arsimor që është mbyllur të gjitha dosjet personale në Arkivin e Shtetit ose Arkivin Rajonal me procesverbal?		
41	Gërma b, Neni 18, Kreu I Udhëzimi nr. 12, datë 27.04.2015,	A i ka dorëzuar drejtori i institucionit arsimor, që është bashkuar me një institucion tjetër, drejtorit të institucionit arsimor të bashkuar dosjet personale të subjekteve, që shkojnë tek institucioni arsimor i bashkuar me procesverbal?		
42	Gërma c, Neni 18, Kreu I Udhëzimi nr. 12, datë 27.04.2015,	Kur një subjekt i një institucioni arsimor është transferuar në një institucion tjetër arsimor, a i ka dorëzuar drejtori i institucionit, drejtorit të institucionit arsimor pritës dosjen personale përkatëse me procesverbal?		
43	Gërma d, Neni 18, Kreu I Udhëzimi nr. 12, datë 27.04.2015,	A është lejuar që transferimi i dosjes personale të bëhet nga personi të cilit i përket dosja?		

Nr .	Baza Ligjore	Pyetje	Vlerësimi (Po/Jo/Nuk Aplikohet)	Komente
44	Neni 19, Kreu I Udhëzimi nr. 12, datë 27.04.2015,	A kanë hartuar grupi i punës, i kryesuar nga drejtori i institucionit arsimor dhe i përbërë nga anëtarët e drejtorisë së institucionit arsimor, kryetari i bordit të institucionit, kryetari i këshillit të prindërve të institucionit dhe dy mësues, të zgjedhur nga këshilli i mësuesve, rregulloren e brendshme për sigurinë dhe fshehtësinë (konfidencialitetin) e të dhënave personale dhe dosjeve personale të subjekteve?		
45	Neni 20, Kreu I Udhëzimi nr. 12, datë 27.04.2015,	A ka marrë drejtori i institucionit masa administrative dhe disiplinore, sipas akteve normative të miratuara nga ministri përgjegjës për arsimin, kur kontrolluesi/përpunuesi ka kryer shkelje në procedurat e përpunimit, mbrojtjes dhe sigurisë së të dhënave personale dhe kur veprimet e tij nuk përbënin vepër penale?		
46	Neni 21, Kreu I Udhëzimi nr. 12, datë 27.04.2015,	A bashkëpunon institucioni arsimor me komisionerin për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, në përputhje me ushtrimin e të drejtave dhe të detyrave që i janë ngarkuar atij me ligji?		
47	Neni 1, Kreu II Udhëzimi nr. 12, datë 27.04.2015,	A përmban dosja personale e punonjësit arsimor të dhënat sipas shtojcës 1, bashkëlidhur këtij udhëzimi?		
48	Neni 2, Kreu II Udhëzimi nr. 12, datë 27.04.2015,	A është hartuar nga punonjësi arsimor dhe a është dorëzuar me shkrim, dosja personale e punonjësit arsimor në fund të vitit mësimor, te kontrolluesi/ përpunuesi i dosjes personale, me nënshkrimet dhe datën e dorëzimit të punonjësit arsimor dhe kontrolluesit/përpunuesit?		
49	Gërma a, Neni 1, Kreu III Udhëzimi nr. 12, datë 27.04.2015,	A ndodhet dosja personale e nxënësit në amzën e shkollës dhe indeksin alfabetik të amzës?		
50	Gërma b, Neni 1, Kreu III Udhëzimi nr. 12, datë 27.04.2015,	A ndodhet dosja personale e nxënësit në treguesit antropometrikë dhe të cilësive fizike të nxënësve?		
51	Gërma c, Neni 1, Kreu III Udhëzimi nr. 12, datë 27.04.2015,	A ndodhet dosja personale e nxënësit në shtesat e dosjes personale?		

Nr	Baza Ligjore	Pyetje	Vlerësimi (Po/Jo/Nuk Aplikohet)	Komente
52	Neni 2, Kreu III Udhëzimi nr. 12, datë 27.04.2015,	A përmban amza këto të dhëna personale për nxënësin: a) emri mbiemri i nxënësit; b) numri ID; c) gjinia e nxënësit, d) datëlindja e nxënësit; e) vendlindja e nxënësit; f) emri i babait (kujdestarit ligjor); g) emri i nënës (kujdestarit ligjor); h) vendbanimi i nxënësit; i) data e regjistrimit në klasën e parë; j) vlerësimet vjetore sipas planit mësimor përkatës, bazuar në dëftesat/diplomën për çdo klasë të njëpasnjëshme që ka ndjekur; k) raste të veçanta: kalimi në vjeshtë, mbetja në klasë; l) shënimet për karakteristikat e nxënësit dhe vlerësimet për sjelljen, bazuar në dëftesat/diplomën për çdo klasë të njëpasnjëshme që ka ndjekur; m) vlerësimi në provimet e përfundimit të arsimit bazë dhe të arsimit të mesëm të lartë; të dhënat për transferimin e nxënësit (kur nxënësi largohet nga kjo shkollë ose vjen nga një shkollë tjetër) (data e transferimit, emri i shkollës ku transferohet dhe vendi i saj)?		
53	Neni 3, Kreu III Udhëzimi nr. 12, datë 27.04.2015,	A përmban indeksi alfabetik i amzës emrin e mbiemrin e nxënësit dhe numrin e tij të amzës?		
54	Gërma a/b/c/d/e/f/g/h/i, Neni 4, Kreu III Udhëzimi nr. 12, datë 27.04.2015,	A përmbajnë treguesit antropometrikë dhe të cilësive fizike të nxënësit këto të dhëna për nxënësin: a) pesha trupore në kg; b) lartësia trupore në cm; c) treguesit e masës trupore BMI; d) perimetrin e gjoksit në qetësi në cm; e) perimetrin e gjoksit në frymëmarrje në cm; f) perimetri i belit në nivelin e kërthizës në cm (PK); g) perimetri në nivelin e vitheve, muskujve gluteo në cm (PG); h) vlera e raportit PK/PG; i) tregues të tjerë?		
55	Neni 5, Kreu III Udhëzimi nr. 12, datë 27.04.2015,	A janë matur treguesit antropometrikë dhe cilësitë fizike të nxënësit nga mësuesi i edukimit fizik dhe a i janë dorëzuar me shkrim në fund të vitit mësimor, kontrolluesit të dosjes personale të nxënësve, me nënshkrimet dhe datën e dorëzimit të mësuesit dhe kontrolluesit?		

Nr	Baza Ligjore	Pyetje	Vlerësimi (Po/Jo/Nuk Aplikohet)	Komente
56	Gërma a/b/c/d, Neni 6, Kreu III Udhëzimi nr. 12, datë 27.04.2015,	A përmban shtesa e dosjes personale të nxënësit këto të dhëna: a) certifikata për rezultate më të larta vjetore në klasë, në shkollë, si dhe për kontribute në mbarëvajtjen e institucionit arsimor; b) fitues në konkurse, gara në nivel njësie arsimore vendore, kombëtar ose ndërkombëtar; c) pjesëmarrja në qeverinë e nxënësve; pjesëmarrja në komisionin e etikës dhe sjelljes dhe/ose në komisionin e shëndetit, sigurisë, mirëmbajtjes dhe mjedisit?		
57	Neni 8, Kreu III Udhëzimi nr. 12, datë 27.04.2015,	A është plotësuar shtesa e dosjes personale të nxënësit nga mësuesi i tij kujdestar dhe a i është dorëzuar në fund të vitit mësimor kontrolluesit të dosjes personale, me nënshkrimet dhe datën e dorëzimit të mësuesit dhe kontrolluesit?		
58	Neni 8, Kreu III Udhëzimi nr. 12, datë 27.04.2015,	A përmbajnë të dhënat kontaktuese të prindit/kujdestarit përmbajnë informata sipas shtojcës 4, bashkëlidhur udhëzimit 28 (për disa shtesa dhe ndryshime në këtë udhëzim) dhe a janë plotësuar sipas udhëzimit “Për plotësimin e të dhënave kontaktuese të prindit/kujdestarit ligjor”, shtojca 5, bashkëlidhur udhëzimit 28?		
59	Kreu III/1 i shtuar pas Kreut III, Udhëzimi nr. 28, datë 07.09.2018	A përmbajnë të dhënat kontaktuese të prindit/kujdestarit, informata sipas shtojcës 4, bashkëlidhur udhëzimit 28 (për disa shtesa dhe ndryshime në këtë udhëzim) dhe a janë plotësuar sipas udhëzimit “Për plotësimin e të dhënave kontaktuese të prindit/kujdestarit ligjor”, shtojca 5, bashkëlidhur udhëzimit 28?		

**INSPEKTORËT**